Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/1258
Datë: 24.12.2019

Në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe neneve 4, 5, 6, të Udhëzimit Administrativ MAShT nr: 28/2014, për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet fillimi i procesit të verifikimit për këto standarde të profesionit të aprovuara nga Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rritur:

   - Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit, me kodin 7127
   - Rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit, me kodin 7531
   - Automekanikët, me kodin 7231
   - Metalpunues, me kodin 72
   - Punëtorët e impiantit për gjenerimin e energjisë, me kodin 3131
   - Teknikët e inxhinierisë së telekomunikimit, me kodin 3212
   - Punëtorët e kornizave të ndërtimit, me kodin 7119
   - Suvatuesit, me kodin 7123
   - Punëtorët e zejes me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme, me kodin 7318
   - Dizajnerët dhe dekoratorët e enterierit, me kodin 3432
   - Nëpunësi i prodhimit (përpunimit), me kodin 4322

- Teknikët e bujqësisë, me kodin 3142
- Ndërtuesit e shtëpive, me kodin 7111
- Shtruesit e dyshemeve dhe pllakave, me kodin 7122
- Ngjyrosësit dhe punëtorët e ngjashëm, me kodin 7131
- Prodhuesit e tapicerive (sfungjerëve) dhe të ngjashëm, me kodin 7534
- Teknik i operimit me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, me kodin 3511
- Mekanikët e kondicionerëve dhe të ftohjes, me kodin 7127

2. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që të vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

4. Vendimi i dërgohet KAAPRr.

Kryetarja e KD së AKK
Violeta Dema